

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN**  
**NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9426, DATË 06.10.2005 “PËR MBARËSHTIMIN E**  
**BLEGTORISË”, TW NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Në kuadër të reformës së derregullimit dhe me qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, janë analizuar të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në Aneksin 1 dhe 2, të VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

Në përfundim të analizës, ndër të tjera u arrit në konkluzionin se 23 licenca eliminohen.

Me anë të këtyre ndryshimeve, synohet të arrihet: (a) Reduktim i barrierave administrative; (b) Liberalizim i tregut; dhe (c) Përmirësim i mëtejshëm i klimës së biznesit

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij projekt vendimi nuk është i planifikuar, në programin analitik të projekt akteve të Këshillit të Ministrave.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Neni 5, i Ligjit Nr. 10081, datë 23/02/2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon se *“Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, si rregull, kushtet e përgjithshme të licencimit, autorizimit dhe lejimit, organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve, organi kompetent për inspektimin dhe/ose për revokimin e licencës, autorizimit dhe lejes, si dhe shkaqet e revokimit përcaktohen me ligj, ndërsa kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë, autorizim apo leje, afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit miratohen me akt nënligjor, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizim apo leje.”*

Përsa më sipër, me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)” me kodin II.2.A.2. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimtarisë së ndërzimit natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror) do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e ndërzimit natyror duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e kësaj veprimtarie.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektligji nuk për afron asnjë akt komunitar dhe nuk lidhet me zbatimin e ndonjë *acquis* specifik të BE-së.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)” me kodin II.2.A.2. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimtarisë së ndërzimit natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror) do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e ndërzimit natyror duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e kësaj veprimtarie.

#### **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ngarkohet Ministria e Bujqsisw dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për marrjen e masave për zbatimin e këtij projektligji.

#### **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga Ministria e Bujqsisw dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

#### **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL**

**NIKO PELESHI**

**MINISTRI I FINANCAVE DHE  
EKONOMISË**

**ARBEN AHMETAJ**